
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

DATA:27.11.2025

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

Në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Kreu X, Neni 78 për hartimin dhe miratimin e dokumentave standarte të tenderit, për procedurën e prokurimit me objekt:

**“Blerje materiale te buta dhe veshmbathje” për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve
ndarë në lote si më poshtë:**

- **Loti 1 “Blerje materiale të buta”**
- **Loti 2 “Blerje veshmbathje”**

VLERA E FONDIT LIMIT: Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 129,064,688 (njëqind e njëzetë e nëntë milion e gjashtë dhjetë e katër mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë) Lekë pa TVSH ose 1,334,691.71 (një milion e treqind e tridhjetë e katër mijë gjashtëqind e nëntëdhjetë e një e shtatëdhjetë e një) euro pa TVSH.(Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë me datë 26.11.2025 është 96.7) i ndarë në lote si mëposhtë vijon:

- **Loti 1 “Blerje materiale të buta”,** me fond limit 118,872,500 (njëqind e tetëmbëdhjetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë pa TVSH ose 1,229,291.62 (një milion e dyqind e njëzetë e nëntë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e një pikë gjashtëdhjetë e dy) euro pa TVSH.(Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë me datë 27.11.2025 është 96.7).
- **Loti 2 “Blerje veshmbathje”,** me fond limit 10,192,188 (dhjetë milion e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e njëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH ose 105,400.08 (njëqind e pesë mijë e katër qind e pikë tetë) euro pa TVSH (Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë me datë 27.11.2025 është 96.7).

Njësia e Prokurimit paraqet dokumentet e tenderit dhe formularët përkatës të hartuar si më poshtë vijon:

NJOFTIMI I KONTRATËS
(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

Seksioni 1: Autoriteti/Enti Kontraktor

1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri:	Operatori i Blerjeve të Përqendruara
Adresa:	Rruga “Reshit Collaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)
Tel/Faks:	069609227745
E-mail:	sektori_mallrat@obp.al
Adresa e ueb-faqes:	www.obp.al
Personi/at përgjegjës për prokurimin: (emri, e-mail)	V.T, sektori_mallrat@obp.al

1.2 Lloji i Autoritetit/Entit Kontraktor:

Institucion qendror	Institucioni i pavarur
☒	☐
Njësi e autoriteteve vendore	Të tjera
☐	☐

1.3 Kategoria e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Autoritet/Ent kontraktor që prokuron për nevoja të veta	Organ Qendror blerës
☐	☒
I deleguar	Të tjera
☐	☐

1.4. Kontratë në bazë të një marrëveshje të posaçme midis Shqipërisë dhe një shteti tjetër:

Po ☐ **Jo** ☒

1.5 Kontrate që bashkëfinancohet nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar:

Po	☐	Jo	☒
----	--------------------------	----	-------------------------------------

1.6 Kontratë e rezervuar :

Po	☐	Jo	☒
----	--------------------------	----	-------------------------------------

Seksioni 2: Objekti i Kontratës: “Blerje materiale te buta dhe veshmbathje” për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve

2.1 Numri i referencës së procedurës: REF-70535-11-27-2025

Loti 1-REF-70539-11-27-2025

Loti 2-REF-70541-11-27-2025

2.2 Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):

Pizhama	18318300-4
Pantofla	18813200-3
Dyshekë	39143112-4
Batanije	39511100-8
Çarçafë	39512100-5
Këllëfë jastëku	39512500-9
Peshqirë	39514100-9
Jastëkë	39516120-9

2.3 Lloji i “Kontratës Publike për furnizim”

Blerje	Marrje me qira	Blerje me këste	Një kombinim i këtyre
☒	☐	☐	☐

2.4 Kontrata në bazë të Marrëveshjes Kuadër:

Po	☒	Jo	☐
----	-------------------------------------	----	--------------------------

2.5 Lloji i Marrëveshjes Kuadër:

Me një Operator Ekonomik	☐
Me disa Operatorë Ekonomikë	☒
Të gjitha kushtet janë të përcaktuara	Po ☒ Jo ☐

2.6 Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik:

Në rastin e Marrëveshjes Kuadër me një Operator Ekonomik, kur janë përcaktuar të gjitha kushtet, më poshtë të jepen arsyet e përzgjedhjes

--

2.7 Marrëveshje Kudër me disa operatorë ekonomikë:

Numri i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër: 1 (një) operator ekonomik për secilin lot.

2.8 Kushtet që duhet të zbatohen në rastin e rihapjes së konkurrimit:

--	--	--

2.9 Autoriteti Kontraktor/Autoritetet kontraktore ose Enti/Entet kontraktore që do të jenë palë në Marrëveshjen Kuadër:

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

2.10 ërshkrimi i shkurtër i kontratës / Marrëveshjes Kuadër

Fondi limit: 129,064,688 (njëqind e njëzetë e nëntë milion e gjashtë dhjetë e katër mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë) Lekë pa TVSH ose 1,334,691.71 (një milion e treqind e tridhjetë e katër mijë gjashtëqind e nëntëdhjetë e një e shtatëdhjetë e një) euro pa TVSH.(Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqiperise me datë 26.11.2025 është 96.7) e ndarë me 2 (dy) Lote si më poshtë:

- **Loti 1** “Blerje materiale të buta”, me fond limit 118,872,500 (njëqind e tetëmbëdhjetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë pa TVSH ose 1,229,291.62 (një milion e dyqind e njëzetë e nëntë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e një pikë gjashtëdhjetë e dy) euro pa TVSH.(Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqiperise me datë 27.11.2025 është 96.7).
- **Loti 2** “Blerje veshmbathje”, me fond limit 10,192,188 (dhjetë milion e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e njëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH ose 105,400.08 (njëqind e pesë mijë e katër qind e pikë tetë) euro pa TVSH (Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqiperise me datë 27.11.2025 është 96.7).

1. Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi është Nuk aplikohet.**

2. Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

4. Kodi Output: 1234567

5. Tipi:

Investime ☐

Kodi: _____

Vlera: _____

Shërbime **X**

Kodi: _____

Vlera: 129,064,688 **lekë pa TVSH**

2.11 Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës:

Kohëzgjatja **në muaj** ☐☐☐ **ose** 45 (dyzet e pesë) ditë nga dita e nënshkrimit të minikontratës përkatëse

2.11.1. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër:

Kohëzgjatja në muaj: 48 **ose ditë:** _____ (nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër)

Ose fillon më _____/_____/_____ (d/m/v)

mbaron më _____/_____/_____ (d/m/v)

2.12 Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës:

Në magazinat e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në IEVP, Vaqarr.

2.13 Ndarja në Lote:

Po

X

Jo

☐

Nëse po,

2.14 Përshkrimi i shkurtër i Loteve:

- **Loti 1** “Blerje materiale të buta”, me fond limit 118,872,500 (njëqind e tetëmbëdhjetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë pa TVSH ose 1,229,291.62 (një milion e dyqind e njëzetë e nëntë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e një pikë gjashtëdhjetë e dy) euro pa TVSH. (Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqiperise me datë 27.11.2025 është 96.7).
- **Loti 2** “Blerje veshmbathje”, me fond limit 10,192,188 (dhjetë milion e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e njëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH ose 105,400.08 (njëqind e pesë mijë e katër qind e pikë tetë) euro pa TVSH (Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqiperise me datë 27.11.2025 është 96.7).

2.14.1 Një ofertues mund të aplikojë për:

☐ një Lot,

☐ disa Lote,

X të gjitha Lotet.

Për secilin Lot duhet të paraqitet një ofertë e veçantë.

2.14.2 Numri maksimal i Loteve për ofertues:

Specifikoni numrin maksimal të Loteve që mund t'i jepen një ofertuesi: Te gjitha.

2.14.3 Kriteret/rregullat që duhet të zbatohen për të përcaktuar Lotet që do t'i jepen ofertuesit:

2.14.4 Kombinimi i Loteve në një kontratë/kontrata të përbashkëta (Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një Lot):

Po

☐

Jo

X

Nëse po, specifikoni grupin e Loteve që mund të kombinohen

2.15 Pranohen variantet:

Po

☐

Jo

X

2.15.1 Pranohet nënkontraktimi:

Po

☐

Jo

X

Nëse lejohet nënkontraktimi, specifikoni përqindjen e lejuar për nënkontraktim:

(nuk lejohet nënkontraktimi në një masë më të madhe se 50 % e vlerës së kontratës)

2.15.2 Autoriteti/Enti Kontraktor do të kryejë pagesa direkte tek nënkontraktori:

Po

☐

Jo

X

Shënime të tjera (nëse vlerësohen të nevojshme nga autoriteti/enti kontraktor)

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

X ☐

Jo

☐

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja:

Bazuar në nenin 90 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ndalohet mbështetja për:

1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar për sa i përket vërtetimit për xhiron vjetore;

2. Kapaciteti teknik për sa i përket dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme.

Njësia e Prokurimit gjykon se ndalimi i mbështetjes në pikat e sipërcituar është i nevojshëm për arsyet si më poshtë:

1. Ndalimi i mbështetjes në subjektet e tjera për Kapaciteti ekonomik dhe financiar për sa i përket **vërtetimit për xhiron vjetore**, është gjykuar i nevojshëm për të garantuar siguri dhe stabilitet financiar për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Një operator ekonomik duhet të demonstrojë që ka burimet e veta financiare për të përmbushur detyrimet e veta kontraktuale. Nëse operatori ekonomik mbështetet në subjektet e tjera për kapacitetin financiar ekziston rreziku që këto subjekte të mos i përmbushin premtimet ose detyrimet ndaj operatorit që ka kërkuar mbështetje, duke vënë në rrezik realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Pavarësia dhe përgjegjësia e operatorit ekonomik.

Mbështetja në kapacitetet financiare të subjekteve të tjera mund të dobësojë pavarësinë e operatorit ekonomik pasi mund të behet i varur nga palët e treta. Për të siguruar që operatori është plotësisht përgjegjës dhe i aftë për të zbatuar kontratën, kërkohet që ai të ketë kapacitet financiar të pavarur.

Vështirësitë në garantimin e përmbushjes së detyrimeve.

Edhe pse një subjekt tjetër mund të deklarojë mbështetje financiare, nuk ka asnjë garanci absolute që kjo mbështetje do të ofrohet gjatë gjithë kohëzgjatjes së zbatimit të kontratës. Në raste të tilla, autoriteti kontraktues mund të hasë probleme për të zbatuar penalitetet ose për të siguruar ekzekutimin e kontratës.

Duke mos lejuar mbështetjen në kapacitetet financiare të subjekteve të tjera, autoriteti kontraktues synon të sigurojë që vetëm operatorët ekonomikë që janë realisht të aftë dhe të qëndrueshëm financiarisht të marrin pjesë dhe të realizojnë kontratën.

Ky kriter siguron stabilitet në zbatimin e kontratës dhe parandalon rreziqet e mundshme që mund të dalin nga varësia financiare ndaj palëve të treta.

2. Ndalimi i mbështetjes në subjektet e tjera për Kapacitetin teknik për sa i përket furnizimeve të mëparshme të ngjashme, është gjykuar i nevojshëm, për të garantuar se operatori ekonomik ka ekspertizën/përvojën e nevojshme për të përmbushur detyrimet e kontratës në mënyrë efikase dhe cilësore.

Një operator ekonomik që nuk ka kryer furnizime të ngjashme vetë, nuk mund të demostrojë aftësi praktike dhe përvojë të mjaftueshme në realizimin e kontratës. Mbështetja në subjektet e tjera mund të krijojë një situatë ku operatori ekonomik fitues nuk ka ekspertizën e nevojshme për të përmbushur detyrimet e kontratës në mënyrë efikase dhe cilësore.

Duke mos lejuar mbështetjen garantohej që operatori ekonomik i vetëm është përgjegjës për performacën e kontratës. Nëse lejohet mbështetja te subjektet e tjera për furnizimet e ngjashme, mund të krijohen probleme në monitorimin e cilësise dhe përgjegjësisë në rast dështimi, duke pasur parasysh natyrën dhe objektin e kontratës.

Autoriteti kontraktues synon të minimizojë rreziqet e mundshme në zbatimin e kontratës .

Furnizimet e ngjashme janë një tregues i aftësisë së operatorit për të kryer furnizime të cilësisë dhe të standarteve të kërkuara për këtë objekt prokurimi.

Furnizimet e ngjashme të realizuara drejtpërdrejt nga operatori ekonomik janë dëshmi e aftësisë për të kuptuar kërkesat e tregut, menaxhimin e zinxhirit të furnizimit dhe përmbushjen e afateve. Ky kriter synon të rrisë përgjegjshmërinë, të mbrojë konkurrencën e ndershme dhe të minimizojë rreziqet në furnizime duke siguruar që kontrata t'i besohet një operatori të aftë dhe të provuar.

2.17 Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) përdoren standardet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shqërisë së Informacionit:

Po ☐ Jo ☒

2.18. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rast se standardet nuk janë të zbatueshme, merret një miratim paraprak nga Agjencia Kombëtare e Shqërisë së Informacionit:

Po ☐ Jo ☒

Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike

3.1 Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është **2,581,293.76** (dy milion e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tre pikë e shtatëdhjetë e gjashtë ose 26,693.83 (njëzetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre pikë tetëdhjetë e tre) euro pa TVSH. (Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë me datë 27.11.2025 është 96.7)

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

- **Loti 1** Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është 2,377,450 (dy milion e treqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e kaërqind e pesëdhjetë) Lekë pa Tvsh ose 24,585.83 (njëzetë e katër mijë e pesëqind e tetëdhjetë e pesë pikë tetëdhjetë e tre) euro pa TVSH.(Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë me datë 27.11.2025 është 96.7)
- **Loti 2** Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është 203,843.76 (dyqind e tre mijë e tetëqind e dyzetë e tre pikë shtatëdhjetë e gjashtë) Lekë pa Tvsh ose 2,108 (dy mijë e njëqind e tetë) euro pa TVSH.(Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë me datë 27.11.2025 është 96.7)

3.1.2 Autoriteti/Enti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor _____ (të shënohet numri i llogarisë bankare të autoritetit ose entit kontraktor)

Nr	Banka	Nr. i Llogarisë
1.	Credins	AL91 2121 1009 0000 0000 0203 2030

3.1.3 Autoriteti/Enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

- i. garancisë bankare ☒ X
- ose
- ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente ☒ X

3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150 (shprehur në ditë)

Seksioni 4: Procedura

4.1 Lloji i procedurës: E hapur mbi kufirin e lartë monetar

4.2. Është përdorur njoftimi paraprak / periodik i informacionit:

Po ☐ **Jo** ☒ **X**

Nëse Po, numri i referencës është _____

4.2.1. Aplikohet shkurtimi i afatit për pranimin e ofertave (e aplikueshme për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar).

Po ☐ **Jo** ☒ **X**

4.3 Procedurë e rishpallur:

Po

☐

Jo **X**

Nëse është një procedurë e rishpallur, ju lutemi plotësoni të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit _____

b) Objekti i prokurimit të procedurës së anuluar të prokurimit _____

c) Fondi limit i procedurës së anuluar të prokurimit _____ (shuma , monedha)

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) **Oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në kosto** ☐

Sipas rëndësisë:

çmimi ☐ pikët ☐

_____ ☐ pikët ☐

_____ ☐ pikët ☐

_____ ☐ pikët ☐

Autoriteti/ Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

OSE

B) **oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim** **X**

Në rastin e marrëveshjes kuader, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi (Kjo, metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore kur sasi të jenë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar).

4.5 Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:

Data: **05.01.2026 ora 11:00**

Vendi: _____

Kur oferta kërkohet të paraqitet në mënyrë elektronike, ofertuesit duhet ta paraqesin atë në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP, www.obp.al.

Informacioni mbi ofertat e paraqitura në mënyrë elektronike i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë paraqitur oferta, me kërkesë të tyre.

4.6 Aplikohet shkurtimi i afatit për pranimin e ofertave, sipas parashikimeve në nenin 42, pika 6, të LPP (e aplikueshme për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar).

Po

☐

Jo X

Nëse po, argumentoni arsyet e shkurtimit të këtij afati:

•

4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip

X

Anglisht

X

Seksioni 5: Informacione shtesë:

5.1 Dokumente me pagesë (zbatohet vetëm për procedurat që nuk zhvillohen me mjete elektronike):

Po

☐

Jo

X

Nëse po

Monedha

Çmimi

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së Dokumenteve të Tenderit (DT) tek Operatorët Ekonomik. Operatorët Ekonomik të interesuar kanë të drejtë të konsultojnë DT përpara blerjes së tyre.

5.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyra e blerjes së dokumenteve të tenderit (kur është e aplikueshme)

Operatori ekonomik fitues, për nënshkrimin e një kontrate publike duhet të ketë:

- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.
- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softëerike.

Data e dorëzimit të këtij njoftimi 02.12.2025

LOTI 1 “BLERJE MATERIALE TË BUTA”

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të loti 1**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar prej jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohe operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar*”.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit me nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në nenin 43, pika 4 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në pikën 5 të nenit 61 të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit 1**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme

konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 5 (Pesë) punonjës, me kualifikimet si më poshtë:

2 (dy) rrobaqepes veshjesh, në rast se është prodhues vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;
- Listëpagesat e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuara nga legjislacioni tatimor në fuqi.

2 (dy) shofer vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;
- leje drejtimi, e vlefshme;
- Listëpagesat e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuara nga legjislacioni tatimor në fuqi.

1 (një) punonjes për veprimtari ndihmëse ngarkim-shkarkim vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;
- Listëpagesat e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuara nga legjislacioni tatimor në fuqi.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se OE kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri minimal prej 5 punonjësish, përkatësisht

2 (dy) rrobaqepes veshjesh, në rast se është prodhues

Nëse operatori ekonomik prodhon vetë materialet e buta, prania e dy rrobaqepeseve është thelbësore për:Kryerjen e procesit të prerjes dhe qepjes, si dhe proceseve të tjera të punëve për këto materiale; Garantimin e cilësisë së qepjeve dhe në përputhjen e tyre me specifikime teknike; Përmbushjen e kërkesave të volumit të prodhimit brenda afatve kontraktore. Këta punonjës duhet të jenë të deklaruar sipas listëpagesës së muajit të fundit.

Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 2 (dy) persona me profesionin shofer, mundësinë e realizimit të dorëzimeve të shumta ose paralele, sipas nevojave të AK. mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të mallrave objekt prokurimi brenda afateve të ekzekutimit të kontratës

1 (një) punonjes për veprimtari ndihmëse ngarkim-shkarkim arsyetimi Materialet e buta, kërkojnë organizimi fizik të paketimeve, proces të struktuar magazinimi; ngarkim-shkarkim, pergatitjen e artikujve per transport nga magazia në mjetet e shpërndarjes

Ky punonjës garanton se proceset logjistike kryhen në mënyrë të sigurt dhe efikase, duke shmangur dëmtimin e materialeve dhe vonesat e dorëzimit.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike të prodhuesit për të gjitha artikujt objekt prokurimi. Këto dokumente duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në dokumentet e tenderit, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të kërkuara.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve / skedës teknike është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë AK - Organit Qëndror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të percaktuara në DST. Kërkesa për katalogun /skedës teknike siguron disa avantazhe: Besueshmëria e informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmëria me specifikimet teknike: Siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Parandalimi i mashtrimeve: Redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara. Për sa më sipër AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të percaktuara në DST.

4. Operatori ekonomik në rast se nuk është prodhues, duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për produktin e ofruar ku të përcaktohen dhe kontaktet e prodhuesit ose distributorit të autorizuar. Në rast se paraqitet autorizim nga distributor i autorizuar, të paraqitet edhe dokumenti që provon lidhjen, ndërmjet distributorit të autorizuar dhe prodhuesit

Argumentimi: Ky kriter gjen mbështetje në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku është e caktuar: 5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkak që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojnë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor. Autorizimi për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit është një dokumenti domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë për cilësinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues. Autoriteti kontraktor ka nevojë të sigurohet që produktet që po ofrohen janë të besueshme dhe të cilësisë së kërkuar. Autorizimi nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, siguron që çdo produkt të mund të verifikohet dhe të ketë një burim të njohur dhe të verifikuar. Përsa i përket lidhjes midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit, kjo kërkesë është e rëndësishme për të vërtetuar që distributori është i autorizuar dhe se ka një marrëdhënie të ligjshme me prodhuesin. Kjo ndihmon në shmangien e mundësisë së përdorimit të produkteve të falsifikuara ose të paautorizuara. Ky

argumentim i tregon autoritetit kontraktues se ky kriter është thelbësor për të mbrojtur integritetin e procesit të tenderimit dhe për të siguruar që produktet e ofruara janë të besueshme, të certifikuara dhe të vërtetuara si të ligjshme.

5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për transportin e mallrave objekt prokurimit duhet të disponojë, mjetet e mëposhtme:

Mjete	Sasia	Gjendja
Mjet për transportin e mallrave	2 (dy)	Pronësi / Me qera / Huapërdorje

a) Për mjetet e transportit duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe çertifikata e pronësisë së mjetit/ (per mjetet qe kane lejen e qarkullimit te vjeter)

b) Për mjetet e siguruar me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe çertifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë, ose të huapërdorjes (sipas rastit).

Shenim: Kriteri nr.5 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga operatori ekonomik që kualifikohet i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetet që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit sipas afatit të lëvrimit. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar një minimum të mjeteve që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion për zbatimin e kontratës, duke marrë parasysh sasinë e mallit që kërkohet, afatin e lëvrimit të tij nga data e nënshkrimit të kontratës brenda afatit e marreveshjes kuadër.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikata personale të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);
- ISO 14001 “Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.

- ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.
- AK Vlerëson të nevojshëm certifikimin e subjekteve ofertues me ISO 14001 ose ekuivalent, me qëllim garantimin se OE gëzon konfirmimet e nevojshme nga organizmi i vlerësimit të konformitetit, se ka ndërmarrë masa proaktive me qëllim minimizimin e ndikimit negativ në mjedis, si dhe zbaton kuadrin rregullator përkatës në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

6. Certificate OEKO-TEX, Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatë OEKO-TEX për tekstilet, Standarti 100, klasi II, aneksi IV (ose ekuivalente me to), të vlefshme, të prodhuesit të lëndës së parë. Në rastin kur lëndët e para sigurohen nga prodhues të ndryshëm, certifikata ose dokumenti ekuivalent me të, duhet të paraqitet për të gjithë prodhuesit. Për këtë OE pjesëmarrës duhet të paraqesë një autorizim nga prodhuesi i lëndës së parë ku të bëhet lidhja midis prodhuesit dhe OE/distributorit të autorizuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pikë 1/a), nenin 79 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, me qëllim identifikimin e operatorëve ekonomikë të cilët janë të autorizuar të shitjen e produkteve objekt të këtij prokurimi dhe lidhjen me OE dhe prodhuesit. Certifikata Oeko-Tex, Standart 100, është standarti që përfshin artikujt që kanë kontrakt direkt me lëkurën. Ky standart certifikon produktet pasi janë të testuara për substanca të dëmshme për të mbrojtur shëndetin e njeriut (kimikate toksike). Çdo komponent i një produkti, që nga lënda e parë (metrazhi) e deri te aksesorët, duhet të jetë testuar rigorozisht kundër shumë kimikateve toksike. Qëllimi i certifikatës së tekstilit natyror është një praktikë miqësore me mjedisin dhe me përgjegjësi shoqërore që siguron një prodhim të qëndrueshëm, përfshirë etiketimin nga faza e prodhimit e deri në zinxhirin përfundimtar të furnizimit, ndërsa konsideron sigurinë e produktit tek përdoruesi përfundimtar.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Raport Testimi (fletë-analizë) për artikujt objekt prokurimi të lëshuar nga laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi, që vërtetojnë përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta).

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, me anë të së cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për rezultatet zyrtare të lëndës së parë, të lëshuara nga laborator të akredituar, vendas ose të huaj, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Vendosija e këtij kriteri është i domostoshëm për vetë natyrën e objektit të prokurimit dhe për të garantuar cilësinë e mallrave, me qëllim realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

8. OE duhet të paraqesë certifikate/deklarate konformiteti SSH/CE për artikujt objekt prokurimi referuar specifikimeve teknike.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar. Certifikata/deklarata e konformitetit SSH/CE garanton që artikujt e prokurimit përputhen me specifikimet teknike të kërkuara. Kjo siguron që produktet janë të sigurt, të qëndrueshme dhe funksionale sipas parametrave të përcaktuar në dokumentacionin teknik.

Artikujt me certifikatë CE/SSH plotësojnë kërkesat ligjore të Bashkimit Evropian dhe ato kombëtare. Kjo parandalon importin ose përdorimin e produkteve të pasigurta, të paspecifikuara ose të paautorizuara.

Paraqitja e certifikatës ose deklaratës së konformitetit ul rrezikun që OE të marrë artikuj të papërshtatshëm ose të rrezikshëm, duke shmangur kostot shtesë për riparime / ndërhyrje , zëvendësime, ose pasoja, ligjore.

Duke kërkuar certifikatën / deklaratën, OE tregon se procesi i prokurimit është transparent, i dokumentuar dhe i kontrollueshëm, duke forcuar besueshmërinë e institucioneve dhe besimin e palëve të treta.

Kërkesa për konformitet me standarde të njohura (SSH/CE) përputhet me praktikën më të mirë ndërkombëtare të prokurimit publik, duke garantuar një proces konkurrues dhe të drejtë. Certifikata / deklarata e konformitetit është një garanci që produktet e prokurimit janë të sigurt, të standardizuara, dhe përputhen me kërkesat teknike, ligjore dhe etike. Kërkesa e saj mbrojnë institucionin nga rreziqe financiare, ligjore dhe teknike.

9. Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostrat të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike në DST, për artikujt e listuar si më poshtë:

Artikulli	Përshkrimi	Njësia	Sasia
-----------	------------	--------	-------

1	Batanije teke duhet te jene te loguara me thurje (D.P.Burgjeve)	Copë	1
2	Çarçaf tek duhet te jene me logo me printim (D.P.Burgjeve).	Copë	1
3	Këllëf jastëku duhet te jene te loguara me thurje (D.P.Burgjeve)	Copë	1
4	Peshqir duhet te jete me logo me relief i trupezuar (D.P.Burgjeve) , referuar specifikimeve teknike ne DT.	Copë	1

- Mostër duhet të përmbajë “emri i artikullit” datën e zhvillimit të tenderit, emrin e prodhuesit dhe ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e ofertuesit, të cilat do të mbahen nga Autoriteti Kontraktor sipas rregullores.

- Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit në ambientet e OBP-së, në adresën ”*Rruga “Reshit Collaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)*”
- Mostrat duhet të përputhen me cilësimet e dhëna në specifikimet përkatëse.

Mosparaqitja e mostrave është kusht për skualifikim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Autoriteti kontraktor ka gjykuar të arsyeshme paraqitjen e mostrave, duke marrë në konsideratë sasinë e tyre, vlerën e fondit limit, specifikimet e ndryshme që ka secili artikull objekt prokurimi. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve të tjera, Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

Shtojca 7

LOTI 2 “BLERJE VESHMBATHJE”

FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023,2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% vlerës së fondit limit të lotit 2**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, pika 2/c dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke

vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar prej jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar*”.

2.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit me nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në nenin 43, pika 4 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në pikën 5 të nenit 61 të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40 % vlerës së fondit limit të lotit 2**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të

zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog dhe/ose skedë teknike të prodhuesit, në mënyrë që të verifikohet pajtueshmëria e specifikimeve teknike të mallrave të ofertuara me specifikimet teknike të kërkuara nga AK si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Kominoshe Pune (xhakete + pantallona)	Palë	1
3	Papuçe dhome për të sëmure	Palë	1
4	Përparese të bardha mjeku	Copë	1
5	Përparese për guzhinierë	Copë	1
6	Përparese për sanitarë	Copë	1
7	Përparese pune	Copë	1

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve / skedës teknike është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë AK - Organit

Qëndror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të percaktuara në DST. Kërkesa për katalogun /skedës teknike siguron disa avantazhe: Besueshmëria e informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmëria me specifikimet teknike: Siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Parandalimi i mashtrimeve: Redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara. Për sa më sipër AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të percaktuara në DST. Përzgjedhja e artikujve për të cilët kërkohet paraqitja e katalogut / skedës teknike është bërë duke mbajtur në konsideratë verifikimin e specifikimeve teknike, si dhe sasinë e mallrave të kërkuar nga AK përfituese.

3. Operatori ekonomik në rast se nuk është prodhues, duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për produktin e ofruar ku të përcaktohen dhe kontaktet e prodhuesit ose distributorit të autorizuar. Në rast se paraqitet autorizim nga distributor i autorizuar, të paraqitet edhe dokumenti që provon lidhjen, ndërmjet distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.

Argumentimi: Ky kriter gjen mbështetje në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 5 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku është e caktuar: 5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkak që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojnë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor. Autorizimi për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit është një dokumenti domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë për cilësinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues. Autoriteti kontraktor ka nevojë të sigurohet që produktet që po ofrohen janë të besueshme dhe të cilësisë së kërkuar. Autorizimi nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, siguron që çdo produkt të mund të verifikohet dhe të ketë një burim të njohur dhe të verifikuar. Përsa i përket lidhjes midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit, kjo kërkesë është e rëndësishme për të vërtetuar që distributori është i autorizuar dhe se ka një marrëdhënie të ligjshme me prodhuesin. Kjo ndihmon në shmangien e mundësisë së përdorimit të produkteve të falsifikuara ose të paautorizuara. Ky argumentim i tregon autoritetit kontraktues se ky kriter është thelbësor për të mbrojtur integritetin e procesit të tenderimit dhe për të siguruar që produktet e ofruara janë të besueshme, të certifikuar dhe të vërtetuara si të ligjshme.

4. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 3 (tre) punonjës, me kualifikimet si më poshtë:

1 (një) rrobaqepes veshjesh, në rast se është prodhues vërtetuar me:

-kontratën individuale të punës;

- Listëpagesat e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuara nga legjislacioni tatimor në fuqi.

1 (një) shofer vërtetuar me:

-kontratën individuale të punës;

-leje drejtimi, e vlefshme;

-Listëpagesat e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuara nga legjislacioni tatimor në fuqi.

1 (një) punonjes për veprimtari ndihmëse ngarkim-shkarkim vërtetuar me:

-kontratën individuale të punës;

-Listëpagesat e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuara nga legjislacioni tatimor në fuqi

Shenim: Kriteri nr.4 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për transportin e mallrave objekt prokurimit duhet të disponojë, mjetet e mëposhtme:

Mjete	Sasia	Gjendja
Mjet për transportin e mallrave	1 (një)	Pronësi / Me qera / Huapërdorje

a) Për mjetet e transportit duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e pronësisë së mjetit/ (per mjetet qe kane lejen e qarkullimit te vjeter)

b) Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe certifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë, ose të huapërdorjes (sipas rastit).

Shenim: Kriteri nr.5 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga operatori ekonomik që kualifikohet i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetet që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit sipas afatit të lëvrimit. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar një minimum të mjeteve që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion për zbatimin e kontratës, duke marrë parasysh sasinë e mallit që kërkohet, afatin e lëvrimit të tij nga data e nënshkrimit të kontratës brenda afatit të marreveshjes kuadër.

6. Certificate OEKO-TEX,Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatë OEKO-TEX për tekstilet ,Standarti 100,klasi II,aneksi IV (ose ekuivalente me to), të vlefshme, të prodhuesit të lëndës së parë. Në rastin kur lëndët e para sigurohen nga prodhues të ndryshëm, certifikata ose dokumenti ekuivalent me të, duhet të paraqitet për të gjithë prodhuesit. Per kete OE pjesemarres duhet te paraqese nje autorizim nga prodhuesi i lendes se pare ku te behet lidhja midis prodhuesit dhe OE/distributorit te autorizuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, me qëllim identifikimin e operatorëve ekonomik të cilët janë të autorizuar të shitjen e produkteve objekt të këtij prokurimi dhe lidhjen mes OE dhe prodhuesit. Çertifikata Oeko-Tex, Standart 100, është standarti që përfshin artikujt qe kanë kontrakt direkt me lëkurën . Ky standart certifikon produktet pasi janë të testuara për substanca të dëmshme për të mbrojtur shëndetin e njeriut (kimikate toksike). Çdo komponent i një produkti,që nga lënda e parë (metrazhi) e deri te aksesorët , duhet të jetë testuar rigorozisht kunder shume kimikateve toksike. Qëllimi i certifikatës së tekstilit natyror është një praktikë miqësore me mjedisin dhe me përgjegjësi shoqërore që siguron një prodhim të qëndrueshëm,përfshirë etiketimin nga faza e prodhimit e deri ne zinxhirin përfundimtar të furnizimit,ndërsa konsideron sigurinë e produktit tek përdoruesi përfundimtar.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata personale të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- a) ISO 9001 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);
- b) ISO 14001 “Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me piken 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020”Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.

- ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.
- AK Vlerëson të nevojshëm certifikimin e subjekteve ofertues me ISO 14001 ose ekuivalent, me qëllim garantimin se OE gëzon konfirmimet e nevojshme nga organizmi i vlerësimit të konformitetit, se ka ndërmarrë masa proaktive me qëllim minimizimin e ndikimit negativ në mjedis, si dhe zbaton kuadrin rregullator përkatës në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike (për të dy lotet) janë hartuar nga nje grup i posaçem pune nga Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

Njësia e Prokurimit ka hartuar edhe DST-në, nënshkruar në çdo faqe nga Njësia e Prokurimit, pjesë përbërëse të dosjes së prokurimit.

Njësia e prokurimit: